



Prishtinë, 29 janar 2009

Sipas mandatit ligjor të dhënë në Nenet 22.3 dhe 22.4 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 2004/10) të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-08, dhe sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2009 mbi përshkrimin e kushteve për përcaktimin e konsumatorëve të privilegjuar për vitin 2009, nxjerrë nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) me datë 27 janar 2009, Zyra e Rregullatorit për Energji, me datë 29.01.2009 nxori këtë:

## NJOFTIM PUBLIK

### Për dhënien e statusit të konsumatorit të privilegjuar për vitin 2009

Zyra e Rregullatorit për Energji ("ZRRE") **FTON KONSUMATORËT** e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në **Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2009** të lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM), që të dorëzojnë në ZRRE aplikacionin për të marrë Certifikatën e Konsumatorit të Privilegjuar. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten edhe dëshmitë në vijim:

1. Emri dhe lloji i biznesit.
2. Detaje të pikës së kycjes (lidhjes) fizike në sistemin elektrik.
3. Kontrata për furnizim me energji.
4. Pajisjet për matjen e energjisë.

Dëshmitë e kërkuara si dhe aplikacioni i nënshkruar dhe vulosur duhet të dërgohen në adresën:

Zyra e Rregullatorit për Energji, Rruga: "Hamdi Mramori" Nr. 1, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës,  
Telefoni: +381 (0) 38 247 615, Faksi: +381 (0) 38 247 620.

**Forma e aplikacionit për statusin e konsumatorit të privilegjuar për vitin 2009 mund të merret në ZRRE ose në ueb faqe të ZRRE-së [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)**